

Bazuar në dispozitat e nenit 108/A par. 1 dhe 3.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92-së dhe dispozitat nga neni 4 i Rregullave për parashtrim të ankesave – FO1, “Beni Dona PLAST Sh. p. k. Lagja Ulpianë Rr. Imzot Nikë Prelaj 10000 Prishtinë Republika e Kosovës në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit lidhur me këtë lëndë, kundër Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme Akademia e Kosovës për Siguri Publike – Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues – dhënie si dhe i publikuar me datë 02/06/2023; në ueb faqen e platëformës elektronike të KRPP-së Kopje e VENDIMIT –si dhe Vendimit - përgjigje në kërkesën për rishqyrtim e datës 27/12/2023 paraqet:

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ministria e Punëve të Brendshme –10000 Prishtinë Republika e Kosovës

Për Aktivitetin e Prokurimit: Nr. 217 -23 – 5070 -2-1-1 dhe

Ak Nr. i brendshëm. : 21700 /023/ – 068 – 211

Sa i përket te nderit për: Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazernat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren” për nevoja të FSK-së, e ndarë në 3 LOT-e.

LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerna në Prishtinë.

LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazernat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan.

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit** “Beni Dona Plast” SH.P.K Lagja Ulpianë Rr. Imzot Nik Prelaj “Prishtinë dhe

Prishtinë
038 500 893

10000

Prokurimi.zyra@gmail.com

Fadil Paçarada

(Adresa elektronike)

(Nënshkrimi dhe vulq)

05/05/2024



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) (Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. B05- Njoftimi për kontratë: 02.06.2023
2. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Njoftimeve të Publikuara- 09.06.2023
3. Afati për dorëzim të tenderit: 14.07.2023
4. Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
5. Procesverbali i Hapjes së Ofertave: 14.07.2023
6. B58- Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Anulim të Aktivitetit të Prokurimit : 19.09.2023
7. Njoftim për pezullim të aktivitetit të prokurimit: 25.09.2023
8. Ankesa e OE: N.T.P "HAJDINI COMERC ". Nr. 768/23, dërguar në OSHP: 06.10.2023
9. Ekspertiza e Ekspertit Shqyrtues të Prokurimit Nr. 768/2023 e datës: 27.10.2023
10. Vendimi i Panelit Shqyrtues OSHP: 2023/0768 i datës 22.11.2023
11. B58- Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Kontratës: 20.12.2023
12. Kërkesë për Ri-shqyrtim: 26.12.2023
13. Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim: 27.12.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
----	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	----	-------------------------------------	--------------------------

Hapja në mënyrë elektronike e ofertave është bërë me datën 14.07.2023, ora 14:00 - Nuk kemi marrë pjesë në hapje të ofertave.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Jo	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
----	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	----	--------------------------	--------------------------

Me datën 20.12.2023 në Platformën e E-prokurimit, AK ka bërë publikimin e Formularit B58-Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Kontratës:

LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë, me kontratë është shpërblyer Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA"; Delfin L.t.d. SH.P.K në vlerë prej: **3,998,750.00 €**

LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazemat Istog, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan, me kontratë është shpërblyer Grupi i OE: NNH" Verona; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS" në vlerë prej: **4,247,100.00 €**

LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren, me kontratë është shpërblyer kompania jone Beni Dona Plast SHPK, në vlerë prej: **3,914,750.00 €**

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po	<input checked="" type="checkbox"/>
----	-------------------------------------

Jo	<input type="checkbox"/>
----	--------------------------

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 26.12.2023 përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes. Me datën 27.12.2023 përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të Kërkesën tonë për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 1 – Qëllimi;

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;

Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

Shkeljet e dispozitave - Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, janë:

Neni 18.8 - Ndarja e kontratave në Lote

Neni 25 -Kriteret e përzgjedhjes;

Neni 26 - Grupi i Operatorëve Ekonomik;

Neni 40- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes, pas Ri-vlerësimit të ofertave , më datën **20.12.2023** në Platformën e E-prokurimit ka bërë publikimin e Formularit - **B58 - Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues.**

Në këtë vendim, Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes, ka shënuar së shpërblen me kontratë këta OE:

LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë, me kontratë është shpërblyer Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K ne vlere prej:
3,998,750.00 €

LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazemat Istog, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan, me kontratë është shpërblyer Grupi i OE: NNH” Verona; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS” në vlerë prej: **4,247,100.00 €**

Pasi kemi analizuar, Formularit - B58 - Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me datën **21.12.2023** përmes Platformës së E-prokurimit kemi dërguar të Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes, kërkesën për qasje në dokumentet e tenderit dhe ofertat e **Grupit të OE: NTP”GLOBAL PARAJSA” ; Delfin L.t.d. SH.P.K dhe Grupit të OE: NNH” Verona; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS”.**

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes me datën **22.12.2023** na ka lejuar qasje në dokumentet e tenderit dhe ofertat e të dy grupeve të OE të cekur me lartë.

Kemi analizuar të gjithë dokumentacionin e tenderit që kemi pranuar nga AK , duke përfshi edhe ofertat e Grupit të OE: NTP”GLOBAL PARAJSA” ; Delfin L.t.d. SH.P.K dhe Grupit të OE: NNH” Verona; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS”, dhe kemi konstatuar së **Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes, gjatë Ri-vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje substanciale të dispozitave të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.**

Bazuar në nenin **108/A të LPP**, më datën **26.12.2023** përmes Platformës së E-Prokurimit kemi dërguar të Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes Kërkesën për Rishqyrtim. Në këtë Kërkesë për Rishqyrtim i kemi cekur dhe faktuar të gjitha pretendimet tona ankimore.

Më datën **27.12.2023** Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes në Platformën e E-Prokurimit e ka publikuar Vendimin për refuzim si të pa bazuar të Kërkesës tonë për Rishqyrtim. Në bazë të të dhënave që AK- Ministria e Mbrojtjes ka shënuar në këtë vendim, shihet që AK fare nuk është marrë me trajtimin e pretendimeve tona ankimore. Këtë e dëshmon fakti që në vendimin e refuzimit të Kërkesës tonë për Rishqyrtim i ka shënuar vetëm dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik që në kemi shënuar në Kërkesën për Rishqyrtim, por nuk ka dhënë asnjë arsytim për asnjërin nga pretendimet tona ankimore të cilat ne i kemi shënuar dhe faktuar me dëshmi në Kërkesën tonë për Rishqyrtim. AK- Ministria e Mbrojtjes e ballafaquar me fakte dhe dëshmi bindëse që gjatë Ri-vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje substanciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik, në vendimin e datës **27.12.2023** për refuzim të Kërkesës tonë për Rishqyrtim, shënon një arsytim të pa qëndrueshëm (të përgjithësuar) dhe të pa bazuar në asnjë fakt dhe argument.

Pretendimet tona ankimore lidhur me vendimin e AK që ka të beje me shpërblimin me kontrate për LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë, që me kontrate është shpërblyer Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K në vlerë prej: 3,998,750.00 €

Pretendimi 1:

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit (FDT) të neni 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe në Njoftimin për Kontrate të neni III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, të kërkesa nr. 13 ka kërkuar:

Kërkesa 13. Operatori ekonomik duhet të ofroje dëshmi për produktet e ofruara me te cilat oferton e qe do te jene pjese e përgatitjeve te ushqimit , (sipas menyve te paraqitura ne DT aneksin 1 specifikimet teknike te detyrueshme);

Evidenca 13. Lista e artikujve duke përfshi katalogun ose fotografit për produktet e ofruara me përshkrim emrin e prodhuesit vendin e origjinës si dhe përmbajtjen mbi përbërjen e artikulli, për artikujt që kanë përshkrim teknik , pemët dhe perimet nuk ka nevojë përshkrimi teknik - i vulosur dhe nënshkruar nga OE ne origjinal.

Për ta plotësuar Kërkesën nr. 13, Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K, së bashku më ofertën ka dorëzuar një katalog të përgjithësuar të Kompanisë Delfin L.t.d. SH.P.K, në të cilin janë të pasqyruar disa lloje të artikujve ushqimor që kjo kompani i tregton në tregun e Kosovës por në asnjërin prej tyre nuk është e shënuara përmbajtja e përbërjes së artikujve ashtu siç ka kërkuar AK në kërkesën nr. 13. Gjithashtu në këtë katalog ka edhe artikuj për të cilët është dërguar vetëm fotografia që janë bere në dyqane të ndryshme pa asnjë përshkrim të përbërjes së artikujve. Ka raste kur vetëm i kanë fotografuar vitrinat e dyqanit të mishit dhe të njëjtat fotografi i kanë dërguar të AK së bashku me ofertën pa asnjë përshkrim. (**Dëshmia 1- Katalogu i përgjithësuar i Kompanisë Delfin L.t.d. SH.P.K).**

Gjithashtu së bashku me ofertën është dorëzuar edhe një katalog i kompanisë tregtare ANANAS IMPEX në të cilin janë të shënuara disa artikuj të melmesave të ndryshme që kjo kompani tregtare i tregton në tregun e Kosovës, por edhe në këtë katalog në asnjërin prej tyre nuk është shënuar përmbajtja e përbërjes së artikujve ashtu siç ka kërkuar AK në kërkesën nr. 13. (**Dëshmia 2- Katalogu i përgjithësuar - kompanisë tregtare ANANAS).**

Ky Grup i OE ka dërguar edhe Listat e artikujve pa asnjë përmbajtje të përbërjes së artikujve ashtu siç ka kërkuar AK në kërkesën nr. 13. (**Dëshmia 3 - Listat e artikujve që Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K, ka dorëzuar së bashku më ofertën).**

Prandaj, katalogët, fotografitë dhe Listat e artikujve të cilat i ka dërguar Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K, së bashku me ofertën të AK, **as për se afërmi nuk e plotësojnë kërkesën nr. 13** të kërkuar nga AK në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate, ku saktësisht ka kërkuar - Listën e artikujve duke përfshi katalogun ose fotografit për produktet e ofruara me

përshkrim emrin e prodhuesit vendin e origjinës si dhe përmbajtjen mbi përbërjen e artikulli, për artikujt që kanë përshkrim teknik ndërsa vetëm për pemët dhe perimet nuk ka kërkuar që të bëhet përshkrimi teknik.

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes, në faqen 45 të Dosjes së Tenderit të Aneksi nr. 1- Specifikat Teknike të Detyrueshme - ka vendosur tabelën e Identifikimit të Operatorit Ekonomik (OE), ku ka qene obligim i çdo OE që oferton në këtë aktivitet të prokurimit që ta plotësojë këtë tabelë, ta nënshkruaj, vulosë dhe ta dërgoj të AK së bashku me ofertën.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	

Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K, fare nuk e ka plotësuar, nënshkruar, vulosur dhe dërguar të AK - Aneksin nr. 1- Specifikat Teknike të Detyrueshme. (Dëshmi 4- Faqja 45 e Dosjes së Tenderit).

Bazuar në nenin 56 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP , nenin 59 paragrafi 4 të LPP, nenin 25 paragrafi 1 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik dhe nenin 40 paragrafi 40.2 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik, Autoriteti Kontraktues – Komisioni i Ri vlerësimit të ofertave është dashur që ofertën e Grupit të OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K , automatikisht ta konsideroj si oferte të pa përgjegjshme dhe ta eliminoj nga aktiviteti i prokurimit për faktin që nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret - kërkesat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate, konkretisht kërkesën nr, 13 të Kapacitetit Teknik dhe Profesionale dhe kërkesën për plotësimin dhe dërgimin e Aneksit nr.1- Specifikat Teknike të Detyrueshme

Përshkrimi i nenit 56 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP

1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:
 - 1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

Përshkrimi i nenit 59, paragrafi 4 të LPP

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Përshkrimi i nenit 25, paragrafi 25.1 të Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik

25.1 Sipas Nenit 56 të LPP, një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit nëse:

a. Një OE vërteton të jetë i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe

b. Një OE i tillë, në rast që AK ka përcaktuar kërkesa minimale për kualifikim, përmbush kërkesat e tilla dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhshmëri me nenet 64 deri në 69 të LPP-së.

Përshkrimi i nenit 40, paragrafi 40.2 të Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik

40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Pretendimi 2:

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes në Dosjen e Tenderit në neni 2.5 të FDT - Ndarja në Lote, ka shënuar:

Ndarja në Lote: Po ☒

Objekti i kontratës është i ndare në [3] pjesë (lote). Tenderuesi mund të paraqesë tender [për një apo më shumë pjesët (lote)].

Secila pjesë e lot-it është e shënuar në specifikacionit teknike, shih Aneksin 1, dhe ofertës **financiare Pjesa II. Lista e çmimeve.**

NUMRI MAKSIMAL I PJESËVE QË DO TË MUND TË SHPËRBLEHEN TEK NJË TENDERUES ËSHTË: 1

Rregullat për shpërblimin e lotëve të ndryshme, ku aplikimi për përzgjedhjen e kriterëve për shpërblim do të rezultonte në shpërblimin e një tenderuesi, nëse tenderuesi dorëzon tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët me në më shumë se tre pjesë sa është numri maksimal i pjesëve që mund të shpërblehet një tenderues,

atëherë AK do të shpërblejë OE për LOT-in më të favorshëm për AK sipas nenit 18.7 të rregullores 001/2022 për Prokurim Publik.

Ndërsa me pjesët tjera do të shpërblehen tenderuesit që janë radhitur me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Tenderuesi do të shpërblehet duke filluar me renditje nga vlera më e lartë e parashikuar për pjesë te vlerat më të ulëta të parashikuara për pjesë

Njoftim:

Sipas nenit 18.8 të rregullores 001/2022 për Prokurim Publik. AK- ruan të drejtën se në rast se nuk pranohet oferta te përgjegjshme për ndonjë LOT atëherë do të shpërblehet me shumë LOT-e se një pjesë .

Shembull :

Në rast se kemi shpërblye një OE me një pjesë, mirëpo për lotët tjera nuk kemi asnjë ofertë te përgjegjshëm AK – do të vazhdojë me shpërblye te OE te njëjta edhe në LOT-et tjera në rast se është i përgjegjshëm

Ndërsa në nenin 2.6, të FDT - Vlera e parashikuar për tri vite ka shënuar:

Pjesa 1: 3,340,000 €;

Pjesa 2: 5,280,000.00 €;

Pjesa 3: 4,380,000.00 €;

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes me vendimin që ka marrë për ta shpërblyer me kontratë Grupin e OE: NTP"GLOBAL PARAJSJA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K për LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servis) kazerna në Prishtinë, në vlerë prej 3,998,750.00 €, oferte që e tejkalon substancialisht vlerën e parashikuar nga vete AK për 658,750.00 €, jo vetëm që ka bërë shkelje substanciale të nenit 1 të LPP, nenit 6 paragrafi 1 të LPP, dhe nenit 18 paragrafi 8 të Rregullores nr.01/2022 për Prokurim Publik, por konsiderojmë se ka indikacione të shkaktimit edhe të veprës penale.

Sikur AK - Ministria e Mbrojtjes të kishte vepruar konforme legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës dhe kërkesave që vete AK i ka përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për kontratë, duke përfshi edhe vlerën e parashikuar dhe mundësin që ka pasur që me kontratë të shpërblejë OE edhe për më shumë se një Lot në rast kur nuk ka oferta të përgjegjshme, që në rastin konkret vetëm oferta e kompanisë tone Beni Dona Plast SH.P.K., është oferta e përgjegjshme, buxheti i Republikës së Kosovës vetëm për Lotin 1- nuk do të keqpërdorej për 862,350.00 €. Ky keqpërdorim i mjeteve buxhetore do të ishte parandaluar sikur Autoriteti Kontraktues të kishte vepruar konforme nenit 18.8 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik dhe kritereve që ka caktuar vete në Dosjen e Tenderit në nenin 2.5 të FDT – ku edhe për Lot 1 është dashur që me kontratë të shpërblejë ofertën e vetme të përgjegjshme të kompanisë tone Beni Dona PLast me çmimin total për Lot 1 prej 3,136,400.00 €.

Fatkeqësisht Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes, nuk veproj konforme legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik, por vendosi që me kontrate për **Lot 1** ta shpërblej **Grupin e OE: NTP"GLOBAL PARAJSJA"** ; **Delfin L.t.d. SH.P.K**, oferta e të cilëve jo vetëm që as për se afërmi nuk i plotëson të gjitha kriteret - kërkesat e kërkuar nga AK, por është edhe për **658,750.00 €** me e larte krahasuar me vlerën e **parashikuar nga vete AK për Lot 1** dhe është për **862,350.00 €** me e larte krahasuar me **ofertën e kompanisë tone** si e vetmja oferte e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Komisioni i Ri-vlerësimit të ofertave në faqen 25 të Raportit të Ri- Vlerësimit të Tenderëve, ka shënuar:

- Gjatë analizës së çmimeve komisioni ka konstatuar si në vijim:
 - o Oferta e **Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P. ' GLOBAL PARAJSJA '**; **Delfin L.t.d. SH.P.K**, ka qenë oferta me çmimin më të lartë dhe ka tejkalim nga buxheti i parashikuar në Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve në të tri LOT-et dhe atë si në vijim:
 - LOT 1 - 20%, ose 658,750 euro
 - LOT 2 - 21% ose 1,086,150 euro
 - LOT 3 - 16% apo 853,970 euro

Nga këto të dhëna të shënuara në Raportin e Ri- vlerësimit të ofertave shihet së Grupi i **OE: NTP"GLOBAL PARAJSJA"** ; **Delfin L.t.d. SH.P.K**, në total për **tri lotet** e ka tejkaluar vlerën e parashikuar nga AK në total për **2,598,870.00 €** dhe krahasuar me ofertën tone për të **tri lotet** ka dorëzuar oferte për **4,010,520.00 €** me te shtrenjte së oferta e kompanie ton Beni Dona PLst SH.P.K.

Komisioni i Ri-vlerësimit të ofertave në faqen 26 të Raportit të Ri- Vlerësimit të Tenderëve, ka shënuar:

LOT - 1 . Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P. ' GLOBAL PARAJSJA '; **Delfin L.t.d. SH.P.K** - ka plotësuar minimumin e kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe në përputhje me kriteret për dhënie të kontratës e rekomandojmë për dhënie të kontratës, sepse edhe pse ka ofruar ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lartë për këtë Lot prej **3,998,750.00 €**, duke u bazuar në kriterin e DT dhe Njoftimin për kontratë se një OE mund të shperblehet vetëm më një LOT, atëherë kjo ofertë rezulton te jetë çmimi ekonomikisht më i favorshëm për AK-në.

LOT 1 ka tejkalim nga buxheti i mjete të planifikuara sipas "Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve" prej **20%**, ose **658,750** euro, mirëpo pas kalkulimeve për çmimin e përgjithshëm më të favorshëm del kombinimi më i favorshëm dhe me i lire për AK-në për ta ruajtur buxhetin e AK-së.

Nga këto të dhëna të shënuara në Raportin e Ri- Vlerësimit të Tenderëve , shihet së komisioni i ri-vlerësimit të ofertave e ka pasur shume të qarte së Grupi i **OE: NTP"GLOBAL PARAJSJA"** ; **Delfin L.t.d. SH.P.K**, e ka tejkaluar substancialisht vlerën e parashikuar nga vete AK, por prape së prape ka vazhduar me shpërblim me kontrate këtë Grup të OE për Lot1 duke e dëmtuar buxhetin e qytetareve të Republikës së Kosovës , vetëm për Lot 1 për **862,350.00 €**.

Shtrohet pyetja nga çfarë grupe të interesit u inkurajua ky Grup i OE që të ofertoj me këso çmimesh marramendëse në këtë aktivitet të prokurimit që buxhetin e Republikës së Kosovës të tentojë ta dëmtoj për mbi **katër milion euro**.

Duhet theksuar së përfaqësuesit e kompanisë **NTP"GLOBAL PARAJSJA"** në bashkëpunim edhe me grupe të interesit brenda institucioneve, ka vite që me shantazhe dhe spekulime, tentojnë që më çdo kusht kompaninë tone Beni Dona Plast SH.P.K ta eliminojnë nga tregu duke bere kërkesa për futjen e kompanisë tonë në Listën e zeze, pa kurrfar argumente, duke dërguar shkresa dhe pretendime të pa vërteta në institucione tjera me të vetmin qëllim dëmtimin e reputacionit të kompanisë sonë.

Të gjitha këto shantazhe dhe spekulim,i i bëjnë me të vetmin qellim që të eliminojnë nga tregu konkurrencën dhe të vazhdojnë me zhvatjen e buxhetit të qytetareve të Republikës së Kosovës ashtu siç janë duke tentuar në këtë aktivitet të prokurimit, ku për tri lloje kane ofertuar për **4,010,520.00 €** me çmim me të lartë së oferta e kompanisë ton Beni Dona Plast SH.P.K.

Nëse edhe me tutje vazhdohet me këto shkelje substanciale të legjislacionit të prokurimit publik dhe dëmtim të buxhetit të qytetareve të Republikës së Kosovës për miliona euro, në jemi të detyruar që këtë çështje ta ngrisim në Institucione tjera ligj zbatuese.

Përshkrimi i nenit 1 të LPP

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.
3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Përshkrimi i nenit 6 paragrafi 1 të LPP

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Përshkrimi i nenit 18 paragrafi 18.8 të Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik

18.8 Kur ka kufizim të numrit të Loteve por nuk ka tender të përgjegjshëm të mjaftueshëm për të shpërblyer të gjitha Lotet, atëherë mbizotëron interesi i AK që të shpërblej të gjitha Lotet. Pra, në mungesë të konkurrentëve të tjerë, OE shpërblehen për më shumë Lote se sa numri maksimal i përcaktuar nga AK duke u shpërblyer OE me lotet për të cilat kanë ofruar ofertën më të ulët.

Pretendimet tona ankimore lidhur me vendimin e AK që ka të beje me shpërblimin me kontrate për LOT 2. Grupi i OE: NNH” Verona; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS” në vlerë prej: 4,247,100.00 €

Pretendimi 1:

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit (FDT) të neni 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe në Njoftimin për Kontrate të neni III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, të kërkesa nr. 10 ka kërkuar:

Kërkesa 10. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjte apo te ngjashme ne fushën e gastronomisë (përgatitje dhe servime të ushqimit gjate 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontratë), me institucion publike dhe private, jo me pak se Pjesa 1 2,000,000.00 € ; minimumi i kësaj vlerë të kërkuar duhet të jetë për shërbime 50% (1,000,000.00 €) , dhe pjesa tjetër mund të jetë për furnizime; Pjesa 2 2,000,000.00 €; minimumi i kësaj vlerë të kërkuar duhet të jetë për shërbime 50% (1,000,000.00 €), dhe pjesa tjetër mund të jetë për furnizime; Pjesa 3 € 2,000,000.00 €; minimumi i kësaj vlerë të kërkuar duhet të jetë për shërbime 50% (1,000,000.00 €) , dhe pjesa tjetër mund të jetë për furnizime;

SHËNIM PLOTËSUESE Në rast se Operatori ekonomik dorëzon tender me shumë se një pjesë, atëherë kërkohej qe te plotësohet shuma më e lartë e që kërkohej për Lotët për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE është si me poshtë. 1. Nëse OE vendos që të konkurroj për Pjesën 1 dhe 2, atëherë kërkesa minimale e cila duhet të përmbushet nga OE është 2,000,000.00 Euro 2. Nëse OE vendos qe të konkurroj ne Pjesën 2 dhe 3, atëherë kërkesa minimale e cila duhet të përmbushet nga OE është 2,000,000.00 Euro 3. Nëse OE vendos qe të konkurroj për të 3 Pjesët, atëherë kërkesa minimale e cila duhet të përmbushet nga OE është 2,000,000.00 Euro NJOFTIM Në rast se për tenderin ne fjalë aplikoni si grup i OE atëherë lideri i konzerciumit duhet te përmbushë 50% te vlerës se kërkuar për shërbime € (shërbime është kërkuar minimumi 50% ose 1,000,000.00 € , atëherë lideri duhet te mbuloje minimumi 50% te vlerës për shërbime (500,000.00 €) me kontrata te realizuar dhe vlera tjetër mundet te plotësohet nga anëtarët tjetër te grupit përfshirë shërbimet dhe furnizimet

Evidenca 10 Dëshmia e kërkuar dokumentare Listën e kontratave - projekteve të realizuar përfunduar gjate tri viteve te fundit, në origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, te dëshmuara me referenca në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse , për shërbimet furnizimet e realizuara dhe pranuar , te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës , natyrën e shërbimeve dhe vendin e realizimit të shërbimeve . a. Kur shërbimet furnizimet është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimi ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë.

Për ta plotësuar **Kërkesën nr. 10, Grupi i OE: NNH"Verona"**; **N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS"** së bashku më ofertën ka dorëzuar një Listë të Kontratave të **NNH" Verona"** ku në këtë listë janë shënuar të dhënat e gjashtë kontratave, ku vlera totale e tyre është **1,357,809.36 €**.

Të gjitha këto kontrata janë **kontrata furnizimi** që **NNH "Verona"** ka realizuar në Autoritetin Kontraktues – **Trepça SH.A Mitrovicë**.

Kësaj Listë të kontratave i janë bashkangjitur gjashtë referenca të leshura nga **AK Trepça SH.A** dhe nga dy faqe të kontratës për secilën kontratë.

Nga të dhënat që janë të shënuar në Listën e kontratave, Referenca dhe faqen e parë të kontratës shume qarte shihet së të gjitha këto kontrata titullin e kontratës e kanë : **Furnizim me shujta për punëtorët e Stantërgut dhe kur aktiviteti i prokurimit është zhvilluar sipas Procedurës së Hapur, tri shifrat e fundit të numrit të prokurimit kanë qene: 111- që do të thotë: Furnizim – Vlere e Madhe – Procedure e Hapur dhe kur aktiviteti i prokurimit është zhvilluar sipas Procedurës së Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontrate tri shifrat e fundit të numrit të prokurimit kanë qene: 125 - që do të thotë: Furnizim – Vlere e Mesme – Procedurë e Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontrate. (Dëshmia 1- Listën e kontratave NNH "Verona")**

Së të gjitha këto kontrata janë furnizime e jo shërbime e dëshmon edhe fakti që **NNH" Verona"** së bashku me ofertën ka dorëzuar të AK një Deklaratë ku shënon:

"Të gjitha referencat e prezantuara nga NNH Verona janë Furnizime, në të vërtetë janë shërbime dhe përgatitja e ushqimit për punëtorë e Trepçës në Minierën e Stan Terg-ut-Mitrovicë.

Kjo deklaratë me së miri e dëshmon që Grupi i OE: **NNH"Verona"**; **N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS"**, shume mire e kanë ditur së nuk kanë asnjë kontratë të realizuar si shërbime ashtu siç ka kërkuar AK , por tentojnë që me një **deklaratë mashtruese** ta qesin në lajthitje AK që këto kontrata ti pranoj si kontrata të shërbimeve, e që fatkeqësisht deri në këtë fazë ja kanë arritur qëllimit që të mashtrojnë AK. ".(Dëshmia 2 – Deklarata e NNH Verona e datës **14.07.2023**

Gjithashtu për ta plotësuar kërkesën nr. 10- ky Grup i OE së bashku më ofertën ka dorëzuar një Listë të Kontratave të **N.T.P HAJDINI COMERC** ku në këtë listë janë shënuar të dhënat gjashtë kontratave, ku vlera totale e tyre është **5,037,360.43 €**.

Kësaj Listë ja ka bashkangjitur edhe Referencat e leshura nga Autoritetet Kontraktues ku furnizimet e artikujve ushqimor janë kryer.

Të gjitha këto kontrata janë **kantata furnizimi** të artikujve të ndryshëm ushqimor që **N.T.P HAJDINI COMERC**, ka realizuar në Autoritetet Kontraktuese – **AQP, Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Komuna e Prishtinës. (Dëshmia 3- Listën e kontratave dhe Referencat e N.T.P HAJDINI COMERC).**

Përndaj bazuar në këto që cekem me larte shihet qartë së Grupi i OE: NNH "Verona"; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS" nuk ka të realizuar as edhe një kontratë të vetme të shërbimeve ashtu si e ka kërkuar AK në Dosje të Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Është kërkuar nga AK vlerën prej 2,000,000.00 € ; minimumi i kësaj vlerë të kërkuar duhet të **jetë për shërbime 50% (1,000,000.00 €)**, prandaj Autoriteti Kontrakturës gjate vlerësimit dhe Ri-vlerësimit të ofertave është dashur që të veprojnë konforme nenit 59 të LPP dhe nenit 40 të Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik dhe ofertën e Grupit të OE: NNH "Verona"; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS", ta konsideroj si oferte të pa përgjegjshme dhe ta eliminoj nga aktiviteti i prokurimit pasi që as për së afërmi nuk e ka plotësuar Kërkesën nr. 10 të kërkuar nga AK në Dosje të Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Për informate me të detajizuara së pse këto kontrata që tre numrat e fundit i kane 111 apo 125 , nuk mund të merren si valide për ta plotësuar Kërkesën nr. 10 të AK- Kapacitetet Teknike dhe Profesionale, Ankesës i bashkangjesim Vendimin e Panelit Shqyrtues nr. OSHP-2023/0503 të datës 11.10.2023 dhe Ekspertizën e Ekspertit Shqyrtues Nr. 2023/0503 të datës 27.07.2023.

Paneli shqyrtues i OSHP-së si duket ka marrë dy vendime kundërrthënëse lidhur me të njëjtat kritere /raste , të cilat kanë qenë të specifikuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit për dy aktivitetet të prokurimit: Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e, dhe aktivitetin e prokurimit me titull:Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-se", me numër të prokurimit : 214-23-130-65-2-1-1, të publikuar nga AK –Akademia e Kosovës për Siguri Publike .

Pretendimi 2:

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit (FDT) të neni 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe në Njoftimin për Kontratë të neni III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, të kërkesa **nr. 11** ka kërkuar:

Kërkesa 11. OE duhet të ofroje listën e të punësuarve me specifikimin e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve pjese e këtij tenderi minimumi duhet Për LOT.1- Prishtinë (dy objekte), numri minimal 20 punonjës të kuzhinës dhe minimum 4 punonjës staf profesional - kuzhinierë të kualifikuar në fushën e gastronomisë si dhe një (1) teknolog i ushqimit (teknologu duhet të kenë minimum diplomë bachellor). Për LOT.2 Istog, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan (katër objekte), numri minimal 35 punonjës të kuzhinës dhe minimum 7 punonjës staf profesional- kuzhinierë të kualifikuar në fushën e gastronomisë si dhe një (1) teknolog të ushqimit (teknologu duhet të kenë minimum diplomë bachellor).

Evidenca 11; OE duhet të ofroj dëshmi A) Listën e stafit (një pasqyrë tabelore e personelit) profesional, teknologeve , kuzhinierëve dhe të punëtorëve të kompanisë me të dhënat në vijim Emri , mbiemrin , mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia(vite) dhe pozicioni në kompani, e nënshkruar dhe I vulosur nga OE ne origjinal B). Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit dhe

ndihmës menaxherit, duhet te behet për secilën pjese për të cilën oferton(nëse aplikon për 3 pjesët atëherë kërkohet dhe ndihmës menaxherit i ndare për të tri pjesët dhe nuk mundet te jete i njëjti) C. Për stafin e kërkuar punonjësit e stafit profesional kuzhinierë të kualifikuar në fushën e gastronomisë si dhe teknologët e ushqimit duhet te ofron dëshmitë • Kopje e Diplomës ose Certifikatës

- CV-ja

- Kopja e kontratave të punës ose para kontrata ne original me emër te projektit ne fjale.

Për ta plotësuar Kërkesën 11, Grupi i OE: NNH"Verona"; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti-KS" se bashku me ofertën ka dorëzuar këto dëshmi:

Listën e Teknologeve , Vendimet e caktimit të menaxhereve të kontratës, CV, Diplomat të kopanise "Bylmeti- KS".

Listën e Kuzhinierëve të kompanisë N.T.P HAJDINI COMERC.

Listën e Punonjëseve kompanisë N.T.P HAJDINI COMERC.

Listën e Punonjëseve të kompanisë "Bylmeti- KS".

Vendimin e Ndihmës Menaxhereve të Kontratës të nënshkruar nga pronari i kompanisë N.T.P HAJDINI COMERC.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve të shënuara me larte kemi konstatuar:

Në Listën e Teknologeve të nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i kompanisë "Bylmeti-KS" janë të shënuar këta dy emra: Argjenta Breznica dhe Marjola Memoçela, Ndërsa Vendimet për caktimin e Menaxherit të Projektit për Lot 1 dhe Lotin 2 i ka nënshkruar dhe vulosur Musaj Leku , pronar i kompanisë N.T.P HAJDINI COMERC. (Dëshmi 4- Vendimet e caktimit të Menaxherit të Projektit për Lot 1- znj. Argjenta Breznica dhe Lot 2 - znj. Mariola Memoçela)

Konsiderojmë së nënshkrimi i vendimeve të menaxhereve të Projektit për Lot 1 dhe Lot 2 nga pronari i kompanisë N.T.P HAJDINI COMERC është bere në kundërshtim të plote me nenin 26, paragrafi 26.1, pika (c) e Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik, pasi që sipas këtij neni është i obliguar që grupi ta autorizoj partnerin udhëheqës që të veprojnë në emër të grupit e jo të pranojnë në emër të grupit edhe persona tjerë. Sipas këtij neni të rregullores nuk ka mundësi që të emërohen dy liderë dhe të nënshkruajnë dokumente dy persona në emër të të njëjtit grup.

Në rastin konkret, Grupi i OE: NNH"Verona"; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS" në Deklaratën e Themelimit te Grupit të OE, në preambulën e kësaj deklarate ka shënuar :

Në emër të Grupit NNH " VERONA" ME NUI 811309097, (në vazhdim "tenderuesi"

Gjithashtu në piken d) të Deklaratës shënon:

d) Palët deklarojnë qarte se të gjithë anëtarët e grupit autorizojnë partnerin kryesor NNH “**VERONA**”. Për të vepruar në emër të grupit dhe do të jete **Kajtaž Kajtazi** personi i autorizuar për të nënshkruar Formularin e Tenderit dhe nënshkrimin e Kontratës. (**Dëshmia 5 – Deklarate mbi Themelimit e Grupit e datës 14.07.2023**).

Në piken d) të Deklaratës OE ceken disa nga dokumentet që do të nënshkruhen nga Hajdini Comerc, por kjo klauzole është në kundërshtim të plote me nenin 26, paragrafi 26.1, pika (c) e Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik, pasi që nuk ka mundësi që të emërohen dy liderë dhe të nënshkruajnë dokumente në emër të grupit dy persona në emër të të njëjtit grup të OE.

Në Deklaratën e garancionet për artikujt ushqimor shënon:

Grupi i Operatoreve Ekonomik: **Përkatësisht NTP “Hajdini Comerc”, me NUI: 810248220 si Lider**, jep garancion që artikujt ushqimor që do të ofrohen në përgatitjen e Ushqimit janë të standardeve që janë kërkuar në Aneksin Nr.1 shih katalogun e bashkangjitur me specifikimet teknike dhe foto”. (**Dëshmia 6 – Deklarate për garancionin e artikujve e datës 14.07.2023**).

Në Formularin e Tenderit që e gjeneron Platforma e E-Prokurimit, shënon:

Partneri 1- **N.T.P "HAJDINI COMERC "**

Partneri 2. **NNH,, Verona "**

Partneri 3. **BYLMETI – KS**

Dëshmia 7- Formulari i Tenderit i datës 14.07.2023

Bazuar në këto të dhëna shihet se dokumentacioni i tenderit është nënshkruar nga dy përfaqësues të Grupit të OE, ku here është paraqitur NNH”VERONA” si lider i grupit e here N.T.P "HAJDINI COMERC” si lider i grupit.

Edhe ky veprim i Grupit të OE: NNH”Verona”; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS” është në kundërshtim të plote me nenin 26, paragrafi 26.1, pika c e Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik.

Përkthim i nenit 26, paragrafi 26.1, pika c e Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik.

Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm

Pretendimi 3:

Në Listën e Kuzhinierëve të kompanisë N.T.P HAJDINI COMERC janë të shënuar emrat e 11 Kuzhinierëve, por në tri Diploma – Certifikata nuk shihet fara vula e Institucionit që ka lëshuar Diplomen- Certifikatën dhe në dy prej tyre mund të ketë pasur ndërhyrje në të dhënat e shënuara në këtë Certifikatë.

Këto lëshime janë :

Nr. 2- Fatmir Nika- Diplome e pa vulosur- (**Dëshmia 8- Diploma e Fatmir Nika e datës 03.09.2001**);

Nr. 3- Drita Çuni – Në certifikate nuk shihet vula dhe mund të ketë pasur ndërhyrje. (**Dëshmia 9- Certifikata e Drita Çuni e datës 08.06.2015**);

Nr. 6- Fatime Redja- Në certifikate nuk shihet vula dhe mund të ketë pasur ndërhyrje. (**Dëshmia 10- Certifikata e Fatime Redza e datës 28.10.2013**);

Pretendimi 4:

Në Listën e Punonjëseve të kompanisë “ Bylmeti- KS”, janë të shënuara emrat e 55 të punësuarve dhe të rubrika – Pozicioni në kompani, për 53 prej punëtoreve, shënon – Ndhmës në Kuzhine.

Konsiderojmë së këto të dhëna të shënuar në këtë liste nuk janë sakta dhe mund të konsiderohen edhe si mashtruese, për faktin që një kompani që merret ekskluzivisht me prodhimin e qumështit, në asnjë mënyrë nuk ka mundësi që ti ketë të punësuar 53 Ndhmës në Kuzhine. (**Dëshmia 11- Lista e të punonjëseve të kompanisë “ Bylmeti- KS”**).

Pretendimi 5:

Në vendimin e anëtarit të konzorciumit Hajdini Commerce të datës 14.07.2023 Mbi caktimin e Ndhmës Menaxherit në Projekt pos tjerash shënon:

Menaxher të projektit , cakton z. Fatmir Nika – Kuzhinjer.

Ky përshkrim në këtë vendim , automatikisht Vendimin e caktimit të Ndhmës Menaxherit të Projektit e bene jo valid për faktin së në një vend të këtij vendimi shënon **“Mbi caktimin e Ndhmës Menaxherit në Projekt”** ndërsa ne një vend tjetër të po këtij vendimi shënon: **“Menaxher të Projektit , cakton z. Fatmir Nika – Kuzhinjer”**.(**Dëshmia 12 Vendimi Mbi caktimin e Ndhmës Menaxherit në Projekt i datës 14.07.2023**).

Nga të dhënat e shënuara shihet së Oferta e **Grupit të OE: NNH” Verona; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS”,** as për së afërmi nuk i plotëson kriteret- kërkesat e AK të kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate.

Bazuar në **nenin 56 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP , nenin 59 paragrafi 4 të LPP, nenin 25 paragrafi 1 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik dhe nenin 40 paragrafi 40.2 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik,** Autoriteti Kontraktues – Komisioni i Ri vlerësimit të ofertave është dashur që edhe ofertën e **Grupit të OE: NNH” Verona; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS”,** automatikisht ta konsideroj si oferte të pa përgjegjshme dhe ta eliminoj nga aktiviteti i prokurimit për faktin së nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret - kërkesat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate, **konkretisht kërkesën nr, 10 dhe 11 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional dhe shkeljet substanciale që ka bere me rastin e paraqitjes së dy liderëve brenda të këtij grupi të OE.**

Bazuar në të gjitha këto që i cekem me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, që Ankesën tone ta konsiderojë si të bazuar, të kërkoj nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes që ta beje anulimin e vendimit të datës 20.12.2023 dhe lenden ta kthejë në Rivlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:


Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës shume voluminoze , shpenzimet e përgatitjes së Kërkesës për Rishqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP dhe fitimet e pritura.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. B05- Njoftimi për kontrate: 02.06.2023;
2. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Njoftimeve të Publikuara- 09.06.2023
3. Procesverbali i Hapjes se Ofertave: 14.07.2023;
4. B58- Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Anulim të Aktivitetit të Prokurimit : 19.09.2023;
5. B58- Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Kontratës: 20.12.2023;
6. Kërkesë për Ri-shqyrtim: 26.12.2023;
7. Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim: 27.12.2023;
8. Dëshmitë prej **nr. 1** deri **nr. 4**, që kane të bëjnë e ofertën e Grupit të OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K;
9. Dëshmitë prej **nr. 1** deri **nr. 11**, që kane të bëjnë e ofertën e Grupit të OE: NNH" Verona; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS";
10. Ekspertiza e Ekspertit Shqyrtues të Prokurimit Nr. 2023/0503 e datës: 27.10.2023;
11. Vendimi i Panelit Shqyrtues OSHP: 2023/0503 i datës 11.10.2023;
12. Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-së;

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

4122	3
27	12
23	

Nr. 3-2/54/2023

Datë: 27.12.2023

Në mbështetje të nenit 108/A të Ligji nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe nenit 8 të Rregullave për parashtrimin ankesave të miratuar nga KRPP-ja, sipas Kërkesës për Rishqyrtim, me numër te protokolli: 3439/H të datës 27.12.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "Beni Dona Plast" Sh.p.k për aktivitetin e prokurimit "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazemat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së", e ndarë në 3 LOT-të. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazemat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren. Numri i prokurimit: 217-23-5070-2-1-1, nr.brendshëm: 21700/23/068/211.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Autoritetit Kontraktues/Ministria e Mbrojtjes, ka bërë rishqyrtimin e kërkesës të parashtruar nga Operatori Ekonomik dhe mori këtë:

VENDIM

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik: "Beni Dona Plast" Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit pas publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së për projektin "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazemat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së", e ndarë në 3 LOT-të. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazemat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren. Numri i prokurimit: 217-23-5070-2-1-1, nr.brendshëm: 21700/23/068/211, të shpallur nga Ministria e Mbrojtjes.

II. VERTETOHET, njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – Ministri e Mbrojtjes për projektin "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazemat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së", e ndarë në 3 LOT-të. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazemat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren. Numri i prokurimit: 217-23-5070-2-1-1, nr.brendshëm: 21700/23/068/211, të datës: 20.12.2023.

III. AUTORIZOHET Autoriteti Kontraktues/Ministria e Mbrojtjes, që të vazhdoj tutje me procedurën e prokurimit.

IV. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues/Ministria e Mbrojtjes, refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të ja komunikoj parashtruesit të kërkesës dhe të gjitha palëve të interesuara.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: Beni Dona Plasht Sh.p.k si palë e pakënaqur ka deponuar kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të AK-MM me datë 27.12.2023, kundër njoftimit mbi vendimit të Autoritetit Kontraktues duke pretenduar se AK gjatë Ri-vlerësimit dhe krahasimit të ofertës ka bërë shkelje të neneve në vijim: të Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 dhe legjislacionit sekondar:

Neni 1, Qëllimi,

Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,

Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave,

Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,

Shkeljet e dispozitave – Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, janë:

Neni 18,8 - Ndarja e kontratave në Lote,

Neni 25 – Kriteret e përzgjedhjes,

Neni 26 – Grupi i Operatorëve ekonomik,

Neni 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,

Përgjigje në pretendimet e Operatorit Ekonomik “Beni Dona Plasht” Sh.p.k,

Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë, komisioni i Ri-vlerësimit të ofertave bazuar në vendimin e Panelit Shqyrtues, me numër protokolli 2023/0768 të datës 22.11.2023, ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në mënyrë të barabartë sepse vlerësimi i tenderëve është bërë në përputhje të plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe kërkesave të përcaktuar në dosjen të tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe Kriterit për Dhënien e Kontratës.

Autoriteti kontraktues ka respektuar në tersi Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i përgjegjshëm, sepse ka ofruar ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lirë.

Autoriteti Kontraktues, bazuar në konstatimet e cekura më lartë për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazemat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren” për nevoja të FSK-së”, e ndarë në 3 LOT-të. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazemat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren. Numri i prokurimit: 217-23-5070-2-1-1, nr.brendshëm: 21700/23/068/211 ‘ ‘ ka respektuar në tërësi dispozitat e legjislacionit në fuqi, andaj mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 20.12.2023.

Andaj, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit AK/MM, duke u bazuar në ato që u tha më lartë, vendosi si në diapozitivin të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtoj ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.

Vendimi i dërgohet:

1x1 AK - Departamentin të Prokurimit dhe Kontratave

1x1 Operatori Ekonomik "Beni Dona Plasht" Sh.p.k,

1x1 Arkivës së AK-MM

Muhamet XHYLANI

UD. Drejtor i Departamentit të
Prokurimit dhe Kontratave, Ministria e Mbrojtjes

